

VENDIM
Nr. 50, datë 20.2.2023

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “SUN ENERGY SOLUTIONS” SHPK NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA CENTRALI FOTOVOLTAIK ME KAPACITET TË INSTALUAR 2 mw, NË SHEQ MARINAS, TOPOJË, BASHKIA FIER

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 4, pika 1, germa “a”, nenit 5, pika 1, germa “a”, dhe nenit 10, pikat 1 dhe 3 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe nenit 15 dhe nenit 19, pika 1, germa “a” të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s” nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 20.2.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 571/1 prot., datë 18.2.2023, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë ‘Sun Energy Solutions’ sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 2 mw, në Sheq Marinas, Topojë, Bashkia Fier”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Sun Energy Solutions” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 571 prot., datë 6.2.2023, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 2 mw, me vendndodhje në fshatin Sheq Marinar, Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier, qarku Fier.

- Në zbatim të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, aplikuesi për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike duhet të depozitojë në ERE: dokumentacionin e përgjithshëm për të gjitha aplikimet për pajisje me licencë (neni 9, pika 1); dokumentacionin specifik për licencën e prodhimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 2.1); shtojcën 1, shtojcën 1A dhe shtojcën 2 të plotësuar; si dhe të ketë kryer pagesën për regjistrim dhe shqyrtim të një aplikimi (aneksi A).

- Aplikuesi ka kryer pagesën, sipas përcaktimeve të aneksit A, “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar.

- Nga shqyrtimi i aplikimit, rezulton se shoqëria “Sun Energy Solutions” sh.p.k. ka plotësuar dokumentacionin në zbatim të rregullores për nenin 9, pikën 1.1, gjerat “a”, “b” dhe “c”; për pikën 1.2, gjerat “a” dhe “d”; për pikën 1.3, gjerën “c”; për pikën 2, gjerat “a”, “b”, “d” “e” dhe “f”.

- Nga ky aplikim rezulton, gjithashtu, se nevojitet të plotësohet dokumentacioni, si vijon:

Neni 9:

- Formati dhe dokumentacioni për aplikim

Pika 1, “Dokumentacioni i përgjithshëm për të gjitha aplikimet për pajisje me licencë”

Pika 1.2, “Dokumentacioni juridik dhe administrativ”

- Germa “b”: Aplikuesi duhet të depozitojë vërtetimin e gjendjes gjyqësore (dëshmi penaliteti) për administratorin dhe për vetë shoqërinë “Sun Energy Solutions” sh.p.k.

- Germa “c”: Aplikuesi duhet të depozitojë në ERE strukturën organizative të shoqërisë “Sun Energy Solutions” sh.p.k., së bashku me stafin teknik të dedikuar për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.

Pika 1.3, “Dokumentacioni financiar dhe fiskal”:

- Germa “a”: Aplikuesi duhet të bëjë me dije nëse ka shlyer gjobën ndaj institucionit të Sigurimeve Shoqërore dhe nëse po, të depozitojë në ERE vërtetimin përkatës për shlyerjen e të gjitha detyrimeve.

- Germa “b”: Aplikuesi duhet të depozitojë letrën e referencës së bankës, origjinale ose fotokopje të njësuar me origjinalin dhe të bëjë me dije hapat e ndjekur për nënshkrimin e kontratës apo marrëveshjes përkatëse me bankën dhe nëse kjo marrëveshje është nënshkruar, duhet ta depozitojë në ERE.

Aplikuesi duhet të depozitojë në ERE aktet përkatëse për të materializuar marrëveshjen e bashkëpunimit dhe/ose llogari bankare të shoqërisë, dokumente në të cilat duhet të vërtetohet se ajo zotëron aftësinë financiare për të garantuar 20% të vlerës së investimit, sipas parashikimeve të planit të biznesit të depozituar nga vetë ajo.

Pika 2, “Dokumentacioni specifik sipas tipit të licencës”

Pika 2.1:

- Germa “c”: Aplikuesi duhet të depozitojë në ERE, në format origjinal, ose fotokopje të njësuar me origjinalin, shkresën e OSSH sh.a. dhe marrëveshjen përkatëse për lidhjen me rrjetin. Po ashtu, duhet të bëjë me dije, nëse ka ndodhur ndryshimi i pikës së lidhjes që referohet në shkresën e OSSH sh.a.

- Gjithashtu, aplikuesi duhet të bëjë me dije nëse ka filluar punimet për ndërtimin e centralit.

- ERE, në zbatim të nenit 38, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, dhe të nenit 5 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, lëshon një licencë për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike deri në 30 vjet, por duke qenë se nga shqyrtimi i dokumentacionit teknik jetëgjatësia e pritshme e centralit rezulton të jetë 25 vjet, atëherë ERE kushtëzohet nga kjo jetëgjatësi në dhënien e afatit maksimal për këtë licencë fotovoltaike, deri në 25 vjet.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Sun Energy Solutions” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaiik me kapacitet të instaluar 2 mw, me vendndodhje në Sheq Marinas, Topojë, Bashkia Fier, për një afat 25-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti